ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **UNIVERSITETI I PRISHTINËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **242-23-12143-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Hartimin e Projekteve për Ndërtim, Objekte shtesë, Renovim dhe Shqyrtim Profesional i konstruksionit nga Aspekti i Stabilitetit dhe Funksionalitetit të UP-së"**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**IPE-PROING SH.P.K.**
NUI	**810841644**
Adresa	**Dardania.Bl1/1 hy.1**
Vendi	**Prishtinë**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**038500055**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Nebi Pllana**
Adresa elektronike	**proing@msn.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**08.12.2023**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Hartimin e Projekteve për Ndërtim, Objekte shtesë, Renovim dhe Shqyrtim Profesional i konstruksionit nga Aspekti i Stabilitetit dhe Funksionalitetit të UP-së"

Me date 14.11.2023 eshte bere Njoftimi Per Kontrate.

Me date 22.11.2023 permes Letërs Standarde kemi bere Kërkesës për sqarimin e tenderit

Me date 24.11.2023 kemi pranuar Pergjigjen nga AK per kerkesen per Sqarim shtese

Me date 29.11.2023 kemi derguar Kerkesen per Rishqyrtim

Me daten 30.11.2023 Kemi Pranuar pergjigjen nga AK ne Kerkesen per Rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kerkese per rishqyrtim lidhur me dosjen e tenderit 29.11.2023

Pergjigja e AK në Kerkesen për Rishqyrtim 30.11.2023

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka bërë shkelje të këtyre neneve të LPP-së gjatë procesit të Njoftimi për Kontratë:

- **Neni 7 i LPP-se- Barzia ne trajtim/Jo Diskriminimi**
- **Neni 51 i LPP-së- Njoftimi i kritereve te perzgjedhjes dhe nenin 25 te rregullores Nr.01/2022 Per Prokurim Publik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pergjigjet e AK ne kerkesen per Rishqyrtim jane ne kundershtim te plote me parimet e prokurimit publik dhe dispozitat e nenit 7 dhe 51 të LPP-se. Pra shihet qarte qe AK ka paraqite ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrate kerkesa dhe kritere perzgjedhese te cilat jane diskriminuese per shume operator ekonomik dhe favorizuese per nje operator te ckatuar ekonomik i PREFERUAR nga autoriteti kontraktues.

Pretendimet tona te paraqitura ne Kerkesen per Rishqyrtim me ane te cilave kemi kerkuar qe te largohen kriteret diskriminuese/favorizuese te cilat reduktojne konkurencen dhe i pershtaten vetem nje operatori ekonomik dhe si te tilla nuk janë fare proporcionale dhe relevante me aktivitetin e prokurimit, **NUK largohen nga Autoriteti kontraktues** me arsyetimin se keto kritere jane te nevojshme per kete lende te prokurimit.

Ne si operator ekonomik jemi fortë të vendosur në kërkesat tona që të njejtat kritere perzgjedhese të dosjes se tenderit të cilat jane **diskriminuese/favorizuese të largohen nga dosja e tenderit** që si të tilla janë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së në menyre që te rritet konkurenca dhe pjesmarrja e sa më shumë operatoreve ekonomik të interesuar

për këtë aktivitet të prokurimit.

Ne do të jemi konsisten në kërkesat tona dhe besojmë që institucionet kompetente në këtë rast OSHP ti ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore në shqyrtimin e ankesës tonë në përputhje me LPP-në dhe ta **detyroj AK** gjatë kësaj faze të aktivitetit të prokurimit ti **largoj kriteret përzedhëse diskriminuese/favorizues** nga dosja e tenderit të cilat i kemi potencuar në pretendimet tona në Kërkesën për Rishqyrtim dhe të njëjtat i paraqesim më poshtë edhe përmes kësaj ankese.

AK ka kërkuar disa çertifikata të cilat edhe **vet nuk dinë se cili institucion vendor apo ndërkomtar i lëshon ato**. Në kërkesën tonë për sqarime shtesë, autoriteti kontraktues NUK tregon se cili institucion i lëshon çertifikatat e kërkuara në DT por thotë se OE duhet të hulumtoj cili institucon i lëshon këto çertifikata. Kurse ne pyetjet tjera per sqarim rreth kualifikimeve dhe pervojes se stafit, AK fare nuk jep pergjigje.

Pra vendosmëria e AK për favorizim të kompanisë që ata e preferojnë është e dukshme dhe si i tillë ky institucion akademik është shqetësues në shkeljen e të drejtave të qytetarëve në përgjithësi dhe të operatorëve ekonomik në veçanti të cilët kanë kapacitete për realizimin e këtij projekti por eleminohen pa snjë bazë me kriteret krejtë formale që fare s'kan të bëjnë me lëndën e prokurimit.

Prandaj kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe paneli Shqyrtues në OSHP që të parandaloj në këtë fazë të prokurimit, diskriminimin e pa nevojshëm të operatorëve ekonomik dhe ta vendos ligjshmërinë në procedurën e prokurimit të këtij tenderi të AK-së. Më poshtë paraqesim pretendimet tona ankimore të njjtat me ato në kërkesën për Rishqyrtim.

Pretendimi i Pare

Autoriteti kontraktues gjatë procesit të hartimit te dosjes se tenderit ka shkele nenin 7 te LPP-se(Barazia ne Trajtim/Jo diskriminimi) sepse ka percaktuar kriteret e perzgjedhjes favorizuese/diskriminuese per operator te caktuar ekonomik. Me kete menyre AK ne kundershtim me kete nen, **redukton dhe eleminon konkurencen** ne mes operatoreve ekonomik dhe diskriminon në dëm te shumë operatoreve ekonomik kurse favorizon ne menyre te nje anshem nje operator te caktuar ekonomik.

AK ka krijuar dhe imponuar rrethana dhe kushte qe rezultojn me diskrimin te shumë operatoreve ekonomik, duke favorizuar vetem nje operator te caktuar.

AK me keto kritere te perzgjedhjes ne kete aktivitet te prokurimit ka kerkuar kushte qe rrjedhin ose i ploteson nje ndermarrje/OE i caktuar. Pra AK me Kriter perzgjedhese ka parandaluar pjesmarrjen e mundeshme te shume operatoreve ekonomik te interesuar duke i dhene favore nje OE te preferuar.

Keto veprime te AK, jane shkelje serioze te dispozitave te LPP-se ne pergjithesi dhe shkelje te nenit 7 ta LPP-se ne veqanti.

Pretendimi i dytë

Autoritet kontraktues ka bërë shkelje të Nenit 51 të LPP-së- Njoftimi i kritereve te perzgjedhjes dhe nenin 25 te rregullores Nr.01/2022 Per Prokurim Publik sepse kërkesat minimale për kualifikim NUK janë drejtpërdrejtë **relevante dhe proporcionale** për objektin e kontratës në fjalë.

Po ashtu AK gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, NUK i ka kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit të OE të rinjë për të formuluar kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike.

Por perkundrazi ka percaktuar kritere te **PA arsyeshme** ne raport me vleren e parashikuar te kontrates qe eshte rreth 124.000,00 €. Shume operator ekonomik qe kane kapacitete teknike dhe profesionale te cilet munden ta realizojne kete kontrate, me keto kritere te perzgjedhjes janë perjashtuar automatikisht nga gara per kualifikim.

Prandaj kerkojm qe Kriteret e perzgjedhjes te percaktuar në **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale/Kapaciteti teknik dhe professional** per pikat ne vijim te cilat konsiderojme se jane diskriminuese/favorizuese te **largohen/riformulohen** në këtë mënyrë:

5.3. Një Inxhinier të diplomuar të Ndërtimtarisë ose master i diplomuar – drejtimi konstruktivë me së paku 6 vite përvojë pune pas diplomimit i certifikuar me IWS.

Dëshmi: Diploma e noterizuara nga vetë inxhinieret para datës se publikimit te njoftimit

- Të largohet nga kjo kerkesë **Çertifikata IWS**.

5.4 OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Hidroteknikë, kërkohet te ketë min. 6 vite përvojë pune (pas diplomimit) –angazhime profesionale. I certifikuar me OHSAS 18001-2007

-- Të largohet nga kjo kerkesë **Çertifikata OHSAS 18001-2007**. Sepse nuk përkon dhe nuk eshte relevante me kete lende te prokurimit.

- 5.6 OE duhet të dëshmoj se ka një inxhinier apo master të diplomuar të Ndërtimtarisë ,drejtimi infrastrukturë Rrugor kërkohet te ketë 6 vite përvojë pune –angazhime profesionale.

- Të largohet nga kjo kerkesë **me drejtim Infrostrukturë rrugore dhe 6 vite pervoje pune**

- 5.7 OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master Makinerisë , Drejtimi - Komunikacion Rrugore kërkohet te ketë 6 vite përvojë pune (pas diplomimit) –angazhime profesionale.

- Të largohet nga kjo kerkesë Drejtimi - Komunikacion Rrugore, kriteri nuk korospodon me aktivitetin e prokurimit sepse nuk kemi te bejme me projektim te rrugeve por te objekteve ndertimore.

- 5.9 OE duhet të dëshmoj se ka një Gjeodet , i liçencuar, kërkohet 2 vite përvojë pune –angazhime profesionale. Te jete i licencuar nga AKK , I certifikuar me Autodesk Civil dhe GIS.

- Të largohet nga kjo kerkesë, **Te jete i licencuar nga AKK i certifikuar me Autodesk Civil dhe GIS**. Sepse kerkesa nuk eshte proporionale dhe as relevante me aktivitetin e prokurimit.

- 5.10 Inxhinier te diplomuar Ndërtimtarisë ose master Drejtimi Konstruktiv min. 6 vite përvojë pune pas diplomimit. te jete i certifikuar me fidic.

- Të largohet nga kjo kerkesë, **te jete i certifikuar me fidic**. Sepse Kerkesa eshte dikriminues/favorizuese per operator te caktuar ekonomik.

5.11 OE duhet te dëshmoj se ka një Arkitekt – Master, 4 vite përvojë pune pas diplomimit. Te jete i certifikuar si Ekspert për Siguri dhe Shëndet ne pune nga Ministria e Financave, Punës dhe Transferimeve. I njëjti duhet te ketë përvoje ne projektimin e trashëgimisë kulturore te paktën një Projekt te realizuar për Trashëgimi Kulturore ne 3 vitet e fundit.

- Të largohet nga kjo kerkesë, **Një Arkitekt dhe i njëjti duhet te ketë përvoje ne projektimin e trashëgimisë kulturore te paktën një Projekt te realizuar për Trashëgimi Kulturore ne 3 vitet e fundit . Te riformulohet Një Ekspert për Siguri dhe Shëndet ne pune nga Ministria e Financave, Punës dhe Transferimeve**. Sepse Ligji per Siguri dhe Shendet ne pune lejon çertifikimin edhe nga profilet e tjera te cilet ekspert kane detyra te njejta per siguri dhe shendet ne pune. Kerkesa ka reduktuar konkurencen dhe pjesmarrjen e me shume operatoreve ekonomik.

- 5.12- Lista e pajisjeve dhe stabilimenteve që duhet ti posedoj OE.

Dëshmia:

2. PAISJE GJEODEZIKE **GPS GNSS RTK**-Advanced Engine System me 1408 kanale satelitore, me dual kamerë në kokë-resiver, controller Handy me dual kamerë në kontroller- terminal, me opsion rilevimi-skanimi 3D me fotografi dhe piketimi real vieë me kamere dhe softëare 3D model.1 copë dhe

5. PAISJE GJEODEZIKE **Dron Advanced Engine** me dual gimbal opsione per dy kamera kompatibil me kamere standard per aerofotogrametri dhe opsion per SLAM LIDAR 3D SCANER SYSTEM, me 55 min max fluturim, me sensor 6 drejtimesh, me kamere. 1 copë

6. PAISJE GJEODEZIKE **Sistem LIDAR 3D** skaner multifunksional me 4 opsione – Hany Station, Mobile Vehicle Station, GNSS RTK station dhe UAV drones Station, per mundesi kombinimi Simulant i Lokalizimit dhe Mapimit-SLAM per perdorim me Dron dhe montim mbi veture me HDR KAMERE Panaromike dhe Mobile Software 1 cope

9. PAISJE KOMPJUTERIKE PC KOMPJUTER për procesim të dhënave GJEODEZIKE dhe për projektim me performance të larta hardverike processor CPU i9, RAMDDR5, Kartelë grafike RTX4080, SSD 1TB. 2 copë

10. PAISJE KOMPJUTERIKE PC KOMPJUTER për procesim të dhënave dhe për projektim me performance të larta hardverike processor CPU i9, **RAMDDR5, Kartelë grafike RTX3060, SSD 500GB**. 2 copë

- Te largohen nga Dëshmia pikat **2, 5, 9 dhe 10** sepse keto pajisje nuk janë kompatibile me këtë lëndë të prokurimit, jane diskriminuese/faorizuese te cilat i referohen nje operatori ekonomik, sidomos pajisjet **Dron Advanced Engine, GPS GNSS RTK, Sistem LIDAR 3D** ku haptes shihet qe kerkesa i eshte refereruar nje operatori ekonomik

te caktuar ne Kosovë qe e posedon nje pajisje të tillë i cili eshte i preferuar nga AK. Keto kerkesa janë **disproporcionale dhe jo relevante** me natyren e lendes se prokurimit dhe si te tilla perbejne shkelje te nenit 51 të LPP-se.

AK te ndermarre veprime konkrete ne korigjimin e dosjes se tenderit ne perputhje me pretendimet tona ankimore te cilat ne perputhje te plote me LPP-ne. Çdo tentim i AK per vazhdim edhe me tutje te ketij aktiviteti te prokurimit pa korigjimin e Kritereve te Perzgjedhjes te cilat jane ne kundershtim me dispozitat e LPP-se e qe i theksuam me larte, na detyron pa vullnetin tone, qe edhe ne te ndermarrim veprimet tjera per realizimin e te drejtave tona përmes institucionet perkatese te zbatimit te ligjit.

Prandaj duke marrë për bazë këto shklejt të LPP-së, kërkojm nga OSHP qe te marre:

VENDIM

- **Të aprovojë** ankesën tone si te **bazuar,**

Të urdhëroj AK që të largoj nga njoftimi për kontrate dhe dosja e tenderit Kriteret e Perzgjedhjes te theksuar me larte për këtë aktivitet të prokurimit të cilat janë diskriminuese/favorizuese..

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nuk ka dëme materiale në këtë fazë të aktivitetit të prokurimit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*